

Seria

Ajo rrëfen - Ajo ndryshon veten... dhe Botën

[1]

CHRISTIANNE ROCHEFORT

REVOLTA E SELINËS

ROMAN

BOTIMET TOENA

Serla

Ajo rrëfen - Ajo ndryshon veten... dhe Botën
[1]

CHRISTIANNE ROCHEFORT

REVOLTA E SELINËS

roman

Përktheu nga origjinali frëngjisht: Blerta Hyska

BOTIMET TOENA

Autore: Christianne Rochefort (Kristianë Roshfor)
Titulli në origjinal: Les stances à Sophie
Botoi në frëngjisht: Éditions Grasset & Fasquelle, 1963.

Cet ouvrage bénéficie du soutien du Ministère Français de l'Europe et des Affaires Etrangères, dans le cadre du Programme d'Aide à la Publication de l'Ambassade de France en Albanie et du Centre National du Livre et de la Lecture.

Ky libër ka mbështetjen e Ministrisë Franceze të Punëve të Jashtme të Evropës dhe të Punëve të Jashtme, në kuadrin e programit të Ndhimës për Botim të Ambasadës Franceze në Shqipëri dhe të Qendrës Kombëtare të Librit dhe të Leximit.

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928960191

© Éditions Grasset & Fasquelle, 1963.
© në shqip Botimet TOENA, 2025

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollësja", nr. 71. Tiranë 1023.
K. Postare 1420.
Tel.: ++355 677070884
Email: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al>

“Kur të takova një mbrëmje në rrugë etj...”

(FOLKLORI)

Puna është që ne, vajzat e shkreta, nuk jemi të mësuar. I futemi gjësë pa pasur informacion. E gjejmë gjënë të ndërtuar tashmë, në dukje të fortë si shkëmb, me sa duket kështu ka qenë gjithmonë, do të vazhdojë deri në fund të kohëve, dhe nuk ka arsye pse të ndryshojë. E tillë është natyra e gjërave. E thonë të gjithë këtë, dhe si fillim, e besojmë: si t'ia bësh ndryshe, pa referenca. Ndonjëherë, habitemi: qenka disi i trashë, sidoqoftë; por për t'i rënë në të që është thjesht marrëzi, duhet kohë dhe një kokë me mend. Ndërkohë, duhet bërë si duhet bërë. Sidomos me burrat babaxhanë, që janë si të thuash fusha jonë natyrore e veprimit, dhe ndaj të cilëve, përmes një ligji fatkeq të mospërcaktimit, ne ndiejmë dobësi që na hutojnë mendjen dhe na hedhin në kontradikta, në mos qoftë budallallëk. E vërteta është që në momentin kur biem në dashuri, duhen vendosur tapa veshësh. Por në atë moment, nuk jemi në gjendje të mendojmë për pasojat.

Përse nuk i rrit flokët? thoshte Filipi – një metër e tetëdhjetë e dy centimetër, bjond, sy blu në vjollcë, hundë e adhureshme, gojë arrogante, ballë i gjerë dhe inteligjent etj., – do të të doja shumë më tepër me flokë të gjatë, se pa ato, të paktën do dukesh si grua, përse ke veshur prapë pantallona, edhe pse e di mirë që të pëlqej më tepër me fustan, nëse më do, thoshte Filipi, ma dhuro këtë kënaqësi të vogël. Dhe atë kënaqësinë tjetër të vogël. Nëse më do, nuk të kushton gjë, thoshte Filipi, në ç’orë fjete dje, dhe çfarë bëre, nëse mund të të pyes, për mendimin tim po humbet kohën kot duke mbushur kokën me lloj – lloj librash që nuk u mban mend një fjalë të vetme. Por ama nuk e ke qepur akoma kopsën, aty, që mungon në xhaketën tënde, mos bëj si e habitur, ta kam thënë që javën e kaluar, e njëjta është, e dalloj. Edhe unë që dal vetëm me vajza të mbajtura mirë, të pispillosura sa më s’ka! Sa do të doja të isha krenar kur të më shikonin me ty! Këto që po i them, janë për ty, e di, nëse nuk do të interesohesha për ty, aq do të më bënte nëse mënyra si jeton të çon drejt katastrofës, do të isha i kënaqur vetëm të argëtohesha me ty siç bëjnë shumica e meshkujve me femrat që e quajnë veten të lira, si ty, tepër të kënaqur që ju këtë lloj lirie doni, ah ah! Për ta është mjaft praktike dhe ekonomike shumë, ti duhet ta dish, sepse ke pasur shumë. Por ja që puna ndryshon kur unë interesohem për ty, atëherë përpiqem të të ndihmoj, thoshte Filipi, edhe ti nga ana jote duhet të përpiqesh, mbaje pirunin në dorën tjetër,

mos qesh kështu është vulgare, mos bëj fluska, janë të pista, mbaje trupin drejt, pi shumë duhan po nxin dhëmbët, mos pi kaq shumë nuk është mirë për një femër, nuk ke çehre të mirë duhet të shkosh te mjeku, Përse nuk gjen një punë të vërtetë në vend që të bësh tridhjetë e gjashtë gjëra kot, moskokëçarja jote më hidhëron, ku do të të çojë, do të shkatërrosh shëndetin me gjithë këto kafe, Më premto që nesër do të flesh në mesnatë, për të më bërë qejfin mua, thoshte Filipi, nëse nuk e bën për mua, bëje për vete të paktën, vras mendjen ç'drejin bën me atë grup dështakësh, çfarë u pëlqen? Ata njerëz nuk bëjnë për ty, ti vlen më shumë se kaq, nëse nuk do t'i takoje më, do të më jepje kënaqësi të madhe; nëse më do, thoshte Filipi, a nuk mund ta bësh këtë që më pëlqen, dhe të mos e bësh këtë që nuk më pëlqen? Nuk është dhe aq e vështirë. Thoshte Filipi dhe unë e dëgjoja gojëhapur, përpija fjalët e tij. Më dukeshin me kuptim.

Dhe pastaj, ku po të çon kjo jetë që po bën? Hë? Si përfundim, ku po të çon?

Çfarë t'i përgjigjem? Kurrkund sigurisht, kurrkund nuk po më çon. Nuk është bërë për të të çuar diku; ku të më çojë? Për çfarë është bërë? – epo unë nuk e di. E shikon, thotë ai me një buzëqeshje dashamirëse, e shikon që nuk e di.

Në fakt nuk shoh më asgjë. Ky njeri është Atila. Aty ku shkel, nuk mbin më bari. Truri im është mbushur me re. Kush jam. Çfarë bëjmë këtu. Mister. Ah, këto mendime të thella të ngatërruara, thotë ai. Kështu duket bukur, shumë poetike(?), por kur i shohim nga

afër është mjegull e të tjera. Mjegull e të tjera, përsërit ai, i kënaqur me formulën. Jeta, jeta, nuk është kjo, jeta është shumë më e thjeshtë, kotelja ime. Nuk ke ndonjëherë dëshirë për jetë normale? thoshte Filipi.

Normale. Çfarë do të thotë kjo? Çfarë është jeta normale sot mbi tokë? Unë e dua, por çfarë është?

Filipi megjithatë dukej se e dinte. Vetësiguria e tij sfidonte pasiguritë e mia, i shpartallonte. Që kur kam njohur Filipin, po shkrihem. Po shpërbëhem, nuk e di ku po shkoj, jam një grimcë pluhuri që endet në hapësirat bosh; dhe në këtë përhumbe, kam vetëm një pikë fikse, vetëm një strehë: krahët e tij. Atje gjithçka është e heshtur, e palëvizshme, e qetë dhe e ngrohtë. Atje është paqja, dhe siguria.

E shikon. E shikon kotelja ime. Që ke nevojë për dikë. Që nuk ia del dot vetëm. Ti hiqesh si krenare por thellë – thellë je një vajzë e vogël që ka nevojë që ta mbrojnë, si gjithë të tjerat. Këtu, këtu, e shikon. A nuk je mirë në krahët e mi?

Po, jam mirë! Po, po. Jam mirë. Ky është problemi. Filipi është i fortë, i sigurt. Ai e di.

Ai është atje. Po flet. Dhe unë e dëgjoja, gojë hapur, me fustan, me flokët deri poshtë supeve, dhe pirunin në dorën e majtë. Shkoja te mjeku, pija kokrrat e verdha. Mbërrija në kohë, duke parë orën që më kishte dhuruar për këtë qëllim, dhe që, për më shumë siguri, e kisha kurdisur para. Unë e doja. Kishte mbrëmje kur bija për të fjetur në mesnatë që t'ia thosha të nesërmen, duke u krenuar, dhe për të

marrë Përgëzimet nga goja e tij: shumë mirë kotelja ime, kështu vazhdo, ke për të parë që do të ndihesh më mirë. Unë ndihesha më mirë. E doja. Rregulloja dhomën time të famshme kur e dija që do të vinte. Nuk e pëlqente dhomën time, por meqë banonte me familjen, duhet të vinte për të fjetur me mua. Përpiquej të mos e vinte re atë që ai e quante prapë rrëmujë, pas gjithë përpjekjeve të mia; të mos shikonte gjërat e ngjitura nëpër mure, disa prej të cilave portrete të mia jo shumë korrekte prej duarsh të ndryshme, dhe kujtime betejash të tjera që nuk kisha hipokrizinë t'i hiqja dhe që e acararin; do të kishte dashur të mos e shikonte shtratin tim, gjendja e rrënuar e të cilit tregonte për të një paradë të papranueshme, sidomos batanijen e urrente, i dukej e shpifur dhe e vendoste edhe ai vetë pas shumë të tjerëve prapanicën e dashur me delikatesë femre, deri ditën kur, duke u fshehur pas arsyesh estetikë dhe Babagjyshit të Krishtlindjes, më dhuroi një të re fringo, pa gjurmë, ku u ndje sakaq më rehat. Ai më donte. Ai donte të mirën time. Dhe asgjë nuk i dukej më e papërputhshme me këtë të mirë që më donte se sa mënyra ime e jetesës, rrethi im, miqtë e mi, zakonet e mia, veshjet e mia, flokët, gjuha ime, shijet e mira, idetë e mia, gjithçka që nuk ishte vetja ime – vetja ime e vërtetë, e fshehur, e mbytur, atë që ai donte aq shumë, që njihej vetëm prej tij, dhe e bërë për t'u nxjerrë në dritë nga duart e tij, si një diamant i nxjerrë nga mbështjella e tij. Dhe unë e dëgjoja gojëhapur, me fustan, me flokët deri në

mes të kurrizit. Dhe pa asnjë tapë veshësh. Madje, ai ka zë kaq të bukur.

- Epo si përfundim, je e lumtur kështu?

Nuk ishte i pari që interesohej për mua, dua të them në atë mënyrë, që e njoh mirë dhe nga e cila, zakonisht, ruhem; një interes i ndriçuar, bujar, për jetën time, punët e mia, madje për mendimet e mia (?) etj. Të tjerë burra kanë hyrë në dhomën time, kanë parë, kanë bërë pyetje, çfarë bën, si jeton, me çfarë, pastaj psherëtinin: kotelja ime e gjorë! ose: lepurushi im i gjorë, ose zoçka ime, ose macka ime, në varësi të nivelit të arsimimit, profesionit apo modës së momentit; madje një herë dëgjova: kafshëza ime e shkretë; ishte nga një film, i kohëve të fundit; gjithmonë vjen nga diçka. Në atë moment, më përkëdhelin fytyrën, më përqafojnë. Do të më Ndhimojnë. Do të më Mbrojnë. Nga bota e poshtër, ku kam humbur. Një kotele e vogël (qen, lepur, kafshë etj.) e humbur. Vajzat e reja në hall i mallëngjejnë.

Kurse unë bezdisem. Nuk jam në hall, me përjashtim të parave që nuk janë kushedi çfarë, dhe vetëkuptohet, unë e kam tmerr punën e mërzitshme dhe është tepër e vështirë të gjesh punë jo të mërzitshme, dhe pikërisht, nëse vërtet interesohen për mua e mira do të ishte që pas fjalëve të bukura të më jepnin ca para, si miq, sepse të tillë thonë që janë. Por bëhet fjalë për mbështetje tërësisht morale. Ndoshta paraja

do të vijë si përfundim, pas përpjekjesh të mëdha nga ana ime duke lejuar të më mbështesin moralisht, të qaj në supin e tyre, pra t'i bëj gjërat sipas rregullave, me durim. Por nëse duhet të punoj, më mirë të bëj putanën, fiton më shumë dhe menjëherë, ose, edhe pse nuk është në karakterin tim (ka tepër telashe) të shkoj në zyrë. Pra, i qetësoj sa më shpejt, jetoj kështu sepse kështu dua. Është mënyra ime. Një vend për të fjetur, ushqim dhe rroba të ngrohta. Pikë. Në këtë mënyrë nuk më çajnë kokën shumë. Është mënyra ime. Nuk ankohem.

Ashtu? Epo nëse nuk ankohesh, unë e paskam gabim? Epo mirë. Mendimet bujare futen brenda, vështrimi, i njomur nga mirësia, bëhet prapë opak. Një kimi e tërë ndodh sa hap e mbyll sytë – nuk e di nëse po më kuptoni, por nuk ka gjë, jam mësuar. Për më tepër, është mjaft misterioze: çfarë ndodhi në të vërtetë? Sepse ishte e thjeshtë në fakt; epo mirë, nuk është më kështu. Jo. Është e ndërlikuar. Me sa duket nuk komunikoni për të njëjtën gjë. Na qenkësh një mekanizëm, që duhej njohur, në të cilin duhet të ishim përfshirë. Do t'i kisha bllokuar mekanizmin. Mirë, le të bllokohet, s'më intereson. Tjetri, ka plot që presin në radhë.

Por Filipin e kam për zemër. Si Filipi nuk ka shumë. Ka vetëm një: ai; vetëm një që ka këta sy dhe këto duar, këtë zë, dhe këtë aftësinë për të më mallëngjyer në vendin e duhur që më bëri të harroja krejtësisht që e kanë dhe pasur dhe të tjerë.

Dhe që e quaj Dashuri.

2

- Atëherë, po apo jo, je e lumtur kështu?

Çfarë t'i them. Po apo jo. E lumtur. Çfarë do të thotë kjo. A e di unë. E lumtur. Jo, sigurisht. Po pastaj?

- As më intereson të jem e lumtur!

- Lëri këto. Do ishe e vetmja. Të gjithë duan të jenë të lumtur.

- Mua nuk më intereson.

- Të jesh fatkeqe enkas vetëm për të mos qenë si të tjerët, sikur e tepron pak me origjinalitetin, nuk të duket?

- Jo Filip... nuk është kështu... mua aq më bën nëse jam si të tjerët apo jo, por nëse të tjerët janë budallenj...

- Ja ku doli flamuri i revoltës. Çfarë po lexon këto kohë maçoku im ? Mao Ce Dunin ?

- France-Dimanche¹ ! Më çanë bythën të gjithë...

- Dhe goxha fjalor.

- ...me lumturinë e tyre! Shahu është i lumtur, Princesha është e lumtur, paketuesi është i lumtur,

¹ Revistë argëtuese

i ka pushtuar mania të gjithë. Dje bleva pak gjalpë, quhej Gjalpi i Mirë të Sjell Lumturi, jo të betohem nuk është barcaletë! Ka edhe llamba të Lumturi së, me sa duket sapo i ndez je i lumtur. Është moda e fundit. Jetuan të gjithë të lumtur dhe patën shumë fëmijë të lumtur. Me bombën atomike mbi kokë. Duke pritur që të bjerë. Dreq.

- Ti dhe bomba jote, kudo e fut.

- Unë e fus kudo? Jam unë që e fus kudo? Dreq o punë. Mos e kam shpikur gjë unë?

- Oh dëgjo, nuk thua dot një fjali pa dreq? U bë monotone në fund të fundit.

- S'kam faj unë, e tillë është tema.

- Çfarë teme? Unë po të flas si të jesh e lumtur, nuk e kuptoj pse duhet dhe ky përbërës.

- Kurse unë po. Lumturia, dreqin.

- Ah ashtu? - Ai psherëtin. - Në këtë rast nuk më mbetet tjetër veç të iki. Nuk e kuptoj çfarë bëj këtu. Unë që dua vetëm të të bëj të lumtur. Që kam vetëm një mendim në kokë : lumturinë tënde. Ai lë bukën, që po thërrmonte; vështrimi i tij largohet nga unë; dielli vishet, toka errësohet. Bëra një gabim. U shpreha. Nuk duhet ta kisha bërë. Përse nuk mund të mbaj gjuhën? Edhe pse e di ç'ndodh sa herë. Kur je i dashuruar duhen jo vetëm tapa veshësh por edhe leukoplast për gojën.

- Vërtet nuk e di pse interesohem për ty. Ti të pret krahët, e di...

O Zot, të lutem bëj diçka. Ai do të largohet. Përgjithmonë. Po unë çfarë do të bëj? Çfarë do të bëj pa të? Ditët bosh, netët...

- Dhe unë kam filluar të lodhem... të mendoj se mos po humb kohë kot. Ndërsa. Psherëtimë. E di çfarë, Selinë, kam arritur në një moment kyç në jetën e një burri. Momenti ku duhen marrë Vendime. Vendime serioze. Por qëlloi që këto vendime varen, pjesërisht, nga ty. Kurse ti! Ti...

Ajjj.

- Kurse ti, je aty, pa parë asgjë, ose edhe nëse sheh është akoma më keq, sepse as nuk do t'ia dish për atë që mund apo nuk mund të bëj, që jam apo nuk jam, jam veç njëri ndër të shumtët...

- Filip...

- Që kalon në jetën tënde. Kurse unë... unë ëndërroj të të mbaj pranë vetes - përgjithmonë -

Aj, aj, aj, aj. Oh zemra ime. Oh, dobësia ime! Oh kjo fjalë! Përse u këputa, m'u pre fuqia papritur? Çfarë ka në këtë fjalë? Çfarë magjie - çfarë helmi?

- ... që luftoj për këtë çdo ditë... Kundër sime ëme; kundër tim eti; që kishin thurur plane të tjera për mua, dhe tani vetëm më sulmojnë! Gjithë ato vajza me tërë të mirat që ime më hodhi në këmbët e mia... dhe unë as iu hodha sytë...A nuk mendon që një vendim i tillë është sakrificë për mua? E prapë duhet të luftoj kundër teje? Nuk do të duroj përjetësisht, e di. Po të paralajmëroj.

Aj.

- Nëse ti nuk do të jesh e lumtur, nuk mund të të detyroj...

Tralala. Lumturia me brirë dhe me këmbë dythundrake, më pret në cep të rrugës. Në mes të rrugës tonë të jetës. Tundimi. Liria, apo Dashuria! Thika në fyt. Dhe në emër të kujt ta refuzosh? Liria. Liria e kujt? Liria. E kujt? E kujt? Je njëzet e shtatë vjeç, thotë Filipi, ka ardhur koha të dish se çfarë do të bësh në jetë. E ke kaluar paksa kohën për ëndërrimet me sy hapur, thotë Filipi. Ka ardhur koha, ka ardhur koha. Përndryshe rrezikon të zgjohesh tepër vonë e të kuptosh që e ke humbur mundësinë (cilën mundësi, cilën mundësi?).

- Po e shoh që nuk thua asgjë. Me sa duket kaq efekt të bëjnë gjithë fjalët e mia...

Duhet të them diçka patjetër. Patjetër.

- Filip...

Pak shkurt sidoqoftë. Kështu mendon dhe ai.

- Po?

- Jo se nuk dua të jem e lumtur, nuk doja të thoja këtë

- Po çfarë atëherë ?

- Unë doja të thoja... (ju lutem, një krehër) nuk bëhet fjalë për këtë... në jetë...

- Ah. Po për çfarë atëherë? - Përgjigju ? - Hë? - Për çfarë bëhet fjalë në jetë?

- Euh. Nuk e di.

- Ah mirë. Sigurisht nëse nuk e di për çfarë bëhet fjalë ia vlen të vuash, çdo ditë të jetës tënde. Të

sakrifikosh lumturinë tënde. Është bukur të vuash për bindjet e tua. Çfarë ka? Epo çfarë ka tani Selinë? Ti po qan?

Çfarë mund të bëj tjetër? Vërtet çfarë mund të bëj? Unë vërtet nuk e di për çfarë bëhet fjalë! Jam lëmsh, nuk po kuptoj asgjë.

- Hë tani maçoku im...

Ai buzëqesh. Ka gjetur forca të reja në konstatimin e dobësisë sime. Është i kënaqur. Më kap dorën.

- Hë tani, nuk do të fillosh të qash para të gjithëve! Njerëzia do të mendojnë se jam i keq, xhelat!...Po ti vërtet beson se dua të të hidhëroj? Unë thjesht po përpiqem të vendos pak rregull në atë kokën tënde të vogël. Ai përkëdhel të sapo cituarën. E ke plot me mendime të gabuara që të lëndojnë. Që fshehin gjërat e vërteta që ndodhen atje... Kurse unë...

Dora e tij fundoset në timen. Erdhën gocet, ai e heq dorën për të kapur pjatën e tij.

- ...dhe unë, e kupton ti, ai gëlltit një goce, nuk dua që të vuash; Kot më kot. Ai e gëlltit. Unë dua që të jesh e lumtur. Ai e gëlltit. Edhe pse nuk do. Ai gëlltit një goce. Kurse ti qan! Jepi, ha, janë shumë të shijshme. Ai gëlltit. Ti lufton sikur unë dua të të jap helm. Helm jam unë? Ai gëlltit një goce. Psherëtin. E vërteta është që ti nuk më do.

- Oh Filip!...

Ai gëlltit dy midhje.

- Atëherë? Atëherë përse nuk u jepesh ndjenjave?

Për parime? Cilat? As ti vetë nuk e di! Përse përpiqesh të mbytësh më të mirën brenda teje? E di unë se çfarë është më e mirë brenda teje. Ai gëlltit një goce.

- Ah? Çfarë është?

- Të qenit grua.

Për fjalë të tilla, veçse ç'janë.

*

E vështroj. Po sikur t'i thosha unë, e di se çfarë ka më të mirë te ty, që je burrë. Po çfarë do të thotë kjo. Ajo që është më e mirë te ty është që je burrë. Pa shih. Ajo që është më e mirë te një banane është që është banane. Në thelb është mjaft e vërtetë. Por një banane është vërtet banane. Rasti është i thjeshtë, kurse një burrë...

- Për çfarë mendon?

- Për asgjë.

Me kalimin e kohës bëhemi më të kujdesshëm. Leukoplasti. Meqë rreziku duket se u largua, Filipi është akoma këtu, po ha goce me pamjen e dikujt që nuk ka ndërmend të lëvizë nga karrigia, unë thjesht duhet të duroj.

- Aspak. E kuptoj që po mendon për diçka E kuptoj gjithmonë kur mendon.

- Po mendoja për bananet.

- Duke ngrënë goce?

- Në fakt është e vërtetë që janë të mira. Ajo që është më e mirë në to janë gocet. Dua të tjera.

- Se mos të prishin?
 - Ça thua, kam stomak prej hekuri.
 - Kështu thonë, por heqin të zitë e ullirit më vonë.
 - Më vonë, bah.
 - Pa shih, nuk the drej.
 - E shikon. Po përmirësohem.
- Ai qesh. Është i kënaqur. Porosit goce të tjera.
- Dua edhe verë tjetër.
 - Çfarë, po ti e përlave gjithë shishen?
 - Si kështu! Po ti?
 - Ti e di mirë që unë vetëm sa e vë në buzë të bardhën. Kurse ti ama më duket se pi shumë... nëse ke ndërmend të pish një shishe të dytë para le *Brouilly*...
 - Nuk do të pi *Brouilly*, do të vazhdoj me këtë; e kam tmerr ndryshimin e verës gjatë të ngrënit.
 - Po me *coq au vin*! Nuk do të pish *Sancerre* me *coq au vin*!
 - Përse?
 - Po ja pra... me *le coq au vin* pihet verë e kuqe... Dhe pastaj ti pi shumë; si grua që je.
 - Dhe çfarë është një grua?
 - Ah ah, ja ku e nxore kokën sërish. Eh, është ajo që ti nuk do të jesh, thotë ai, me të qeshur.
 - Unë?
 - Po, ti!
- Ai qesh. Është i kënaqur. E di për çfarë po flet: e para, se çfarë është një grua, e dyta, që unë nuk dua të jem grua. Unë. Unë që prej muajsh në krahët e tij (pa folur për të tjerët para tij) – Nuk e pranoj Fatin tim prej Gruaje.

- Po pra, pohon ai me një buzëqeshje dashamirëse, ti nuk do të jesh grua.

Fatkeqësi është që për faktin që zotërojmë fjalën, tundohemi vazhdimisht të flasim; ndërsa do të ishte shumë më me mend të heshtnim. Nuk duhet të ishte kaq e thjeshtë; nuk duhet të dilte kështu pa e menduar, duhet të kërkohej një farë doze nga diçka që gjuha të ngrihej; nuk po them ndonjë gjë e madhe, një farë doze nga diçka; për shembull, për të qarë, duhet një farë doze trishtimi në fillim; ose ta kesh zanat, gjë që nuk është e thjeshtë as kjo.

Por ama të gjithë flasin çfarë u vjen për shtat, kur u vjen për shtat dhe si u vjen për shtat. Por nga ana tjetër, çfarë bëhet kur nuk ndodh asgjë. Ka boshllëqe. Fjalët mbushin. Edhe kur dashuron, nuk mbushen të gjitha sekondat e jetës me sa duket; thellë – thellë, jemi të varfër.

Duke pritur vazhdimin, unë po vras mendjen për një përkufizim, çfarë do të thotë ai me “një grua”; sepse unë plotësisht e tillë ndihem dhe kjo më mbush. Kështu që dua të di të tijin. Ai e ka përkufizimin; gjëja është me sirtare, duhet ta dija. Një grua mbi të gjitha është bërë për të dashuruar. Ah, ah, tani u dashka një përkufizim për Dashuroj, dhe paska një sirtar tjetër, bosh, që mban një sirtar tjetër po ashtu bosh.

- Po unë kam kaluar gjithë jetën me këtë! (Leukoplastin, moj bijë, leukoplastin! Tepër vonë.)

Ah jo pra. Jo siç kam dashur unë. Ajo nuk ishte vërtet dashuri. E ka emrin ndryshe (e kisha harruar,

me të tjerët flemë) dhe pastaj do të bëja mirë të mos e kujtoja, nuk ka ndonjë gjë për t'u mburrur, për më tepër që nuk është e këndshme për t'u dëgjuar nga Ai që është I pranishëm dhe që vazhdimisht, për respekt ndaj meje, përpiket ta harroj. Dhe, mund të them ç'më mbeti nga kjo?

- Asgjë.

- Atëherë e shikon. Për çfarë të hyri në punë?

- Meqë nuk ka mbetur asgjë, atëherë nuk ka pse të shqetësohesh.

- Ja, po arsyeton.

Unë arsyetoj.

- Po ti, çfarë bën?

- Unë, thotë ai, flas seriozisht. Të paktën përpiqem. Dhe kam meritë, sepse nuk është e lehtë me ty.

- Ngaqë të përgjigjem kur flet?

- E sheh. Po vazhdon.

- Por Filip...

- E shikon: "por". Gjithmonë por.

- Por ama Filip!...

- "Por".

- Mëëë, mëëëë!

- Shih, mbaje pak veten, do mendojnë se jam me një të çmendur.

- Je me një dele. Nuk është ajo që do ?

- Po flet broçkulla.

- Jam grua, e kam këtë të drejtë!

- Oh, por jo të abuzosh! thotë ai; aq i lumtur.

- Si ta di unë, vajzë e gjorë, kur abuzoj?

- Kur ta them unë.
- Ah ashtu. Të paktën kështu është e thjeshtë.
- Eh po, thotë ai. Është e thjeshtë. E sheh. Shumë e thjeshtë.

Ai e përsërit: është shumë e thjeshtë. Ai më vështron pa folur për një çast, dhe vazhdon:

- Nuk të thotë gjë, kjo thjeshtësi? Nuk të thotë gjë? Nuk e ke provuar kurrë. Nuk ke dashur kurrë, ta provosh. Një pjesë e tërë e jetës tënde që ti nuk e njeh. Megjithatë, nëse e lë veten të përfshihet plotësisht në dashuri, gjë që ti e kundërshton me forcë, ka gëzime të mëdha. Nga të cilat e privon veten. Që rrezikon të mos i njohësh kurrë...

- Por... është Karmel!

- Kaq shumë të tremb Karmel me burrin që do? Sikur të më doje vërtet, Selinë, do të ishte parajsë për ty, ky Karmel! Dëshira jote më e zjarhtë! Nëse ti nuk e do këtë është shumë e thjeshtë, do me thënë që nuk më do. Si thua?

- Filip... Unë të dua...

- Pra? Mund të më duash - plotësisht? ose përndryshe unë...

- Po përse Filip... përse nuk mund të vazhdojmë...

- Sepse unë nuk bëj hile! Sepse unë nuk luaj! Ti, bën hile! Ti luan! Ti nuk e dhuron veten, e jep hua! Dhe mua nuk më intereson huaja! Mund ta marrësh veten mbrapsht, meqë je thjesht e dhënë hua! Dhe që tani! Nuk i je përgjigjur ende pyetje që të bëra pak më parë! Ishte mjaft e qartë megjithatë! Sidoqoftë unë

nuk mund të pres më. Nëse është po, duhet të jetë plotësisht. Ose përndryshe... ose përndryshe mund të jetosh përsëri sipas qejfit tënd. Ktheju lirisë tënde aq të shtrenjtë. Drejtoje vetë jetën tënde, me rezultatet e shkëlqyera që kanë dalë deri tani. Apo jo ? Njëzet e shtat vjeç, moshë e bukur për t'ia filluar. Kemi një ide të qartë të aftësive që zotërojmë. Mund të bëjmë një bilanc të vogël. Suksesi, apo dështimi. Nuk e di si e bën ti tëndin... Por Selinë, ... çfarë pate? Çfarë po bën? Ku po shkon?...

Ku po shkoj ?

- Besoj se bëra mirë që erdha. E mora me mend që do të gjeja në këtë gjendje. Selinë. Selinë hë tani. Më shiko. Vogëlushja ime e shkretë. Këta sy të gjorë...

Ai shkon të marrë peceta të lagura, m'i vendos mbi ballë. Është ulur anash shtratit ku jam plandosur unë, me kokën futur në jastëkë.

- Qetësohu. Hë pra. Qetësohu. Jam unë këtu. A do që të jem këtu ? Eja. Po, Fshihu tek unë. Je e sigurt këtu.

I ika... dhe pastaj nuk kisha më asgjë. Njëzet e shtatë vjetët e mia dhe asgjë. Asgjë në duar. Asgjë. Dhe as atë madje. Asgjë.

- Ja, mbaroi tani, gjithçka u rregullua, gjithçka do të jetë shumë mirë, do ta shohësh. Qetësohu. Hë tani. Ah, sa mirë bëra që u mendova, që nuk e mora ikjen tënde seriozisht, që nuk u dëshpërova... Në fillim isha

i dëshpëruar e di. Të kam shumë për zemër... shumë fort.... Nuk do të kishte qenë e lehtë të jetoja pa ty, e di.... Kur të pashë të largoheshe. Ike si një kafshë e vogël e tërbuar, i le të gjitha, çantën, pallton. Dhe me këtë të ftohtë. Kjo më bëri të ndërroja mendje. Hë Selinë, përpiqu të qetësohesh. Do Zoti nuk je sëmure... Po digjesh...

Shkon të marrë aspirina, peshqirë të tjerë; më përkund .

Nuk shpresonte kaq shumë.

- Duhet të shpërthente herët apo vonë. E dija mirë që të ishte rënduar zemra shumë. E teprova por ashtu duhej, duhej të shpërthente qelbi, ishte shumë e dhimbshme për ty. Qaj, qaj, të bën mirë. E dija që do t'ia dilja, që fortesa do të rrëzohej. Ah, sa u mbrojte!.. Eh sa kishe në prapavijë vogëlushe e gjorë. E merr dot me mend sa ruaje në fund. Që po të helmonte. Zemra ime e vogël. E sheh që ke dhe ti zemër, aq fort sa lufton. Macka ime. Hë tani. Qetësohu. Përpiqu të qetësohesh. Jam unë këtu. Po rri këtu. Të dua. Nuk do të kesh më frikë.

Në mëngjes, mori mjekun në telefon.

- Jam këtu. Nuk do të lë më.

Ah miqtë e mi, më falni, kaq e pata.

Ditën e dasmës jemi gjithmonë me humor të keq. Edhe ai. Po ankohet që kryetari i bashkisë mbajti një fjalim idiot. Sipas tij. Çfarë priste ai, martesë është, jo çmim Nobel. Kryetari bëri fjalim normal. Gjërat duken ashtu si janë. Më pyet përse buzëqesh unë. E çuditshmja është që ai çuditet më shumë se unë. Unë buzëqesh. Më pyet përse buzëqesh. I them që është për të qeshur. Ai nuk këmbëngul. Një grua që sapo ka kaluar një depresion nervor dhe që kushtoi dyqind mijë tulla në klinikë trajtohet me kujdes. Dje më pyeti a je e lumtur dhe lotët filluan të rrjedhin vetë. Me sa duket nuk jam shëruar plotësisht. Ndoshta për këtë nuk shpreh asnjë mendim për të veshurën time (nuk po gjej fjalë tjetër).

Ç’pata? Përse zgjodha këtë tajer mes mijërave? Nuk kisha as pse shihja çmimet, ai më kishte lënë dorë të lirë, me porosinë e nënkuptuar: Të paktën këtë herë bëj një përpjekje. E bëra.

Duke u parë për herë të fundit në pasqyrë në mëngjes, para Nisjes (Lamtumirë dhomë e vogël), e

kuptova që isha në zi. Si kisha mundur ? Atë kapele, mbi kokën time. Unë edhe e kisha provuar, kisha provuar pesëdhjetë. Dhe kisha zgjedhur pikërisht atë. Jam vërtet e madhe. Menjëherë pa e ditur, kisha zbuluar si të vishesh për një varrim tetoje në Romorantin.

Dhe me çmimet e njëjtë jam e sigurt që janë më mirë tani. Pikërisht këtë herë unë nuk shkova atje, te çmimet e njëjtë. Synoja për më lart. Do të vë mend.

Po tani, si t'ia bëj? Nuk shkohet në dasmë, sidomos në dasmën tënde, me pantallona dhe xhakëtë motoristësh. Nuk kam çfarë të vesh, dhe ato pak rroba janë nëpër valixhe. Ishte dëshpërimisht tepër vonë. Thashë me vete: nuk po shkoj. Ne gratë kemi ca bllokime, në lidhje me estetikën, vendime delirante mund të merren për lecat. Mendimi se Gjithçka mund të fillonte nga e para më solli në vete. Thava lotët dhe rimelin që e kisha vendosur për të vënë në dukje efektin makabër, veçanërisht për atë ditë. Isha si mos më keq, kisha vetëm një zgjidhje, të mos ia hidhja sytë pasqyrës gjithë ditën. Isha me vonesë, makina priste, si edhe dëshmitari im, meqë nuk kisha familje.

Kurse ai kishte. Dhe duhet të më shikonte që po vija. Në vështrimet e tyre sodisja imazhin e katrahurës sime; në sytë e tij, turpin. Nuk e priste këtë. As unë, por si t'ia thosha ? Askush nuk do ta trajtonte çështjen, për mirësjellje. Ah, si t'ia bëj që të mos më vënë re fare? Nuk është e lehtë kur je nusja.

Nëna u pushtua nga mëshira. Vajza e shkretë (unë). I biri po martohet me një jetime të gjorë, që nuk di as të vishet. Kur ke fëmijë, këto janë gjëra që i pranon në fund të fundit. Ata të sjellin në shtëpi atë që nuk ta merr mendja, dhe në ditë tona me këtë përzierje të klasave as nuk shprehesh dot se të marrin për të prapambetur. Ajo e çon mendjen te Vajzat e Reja për së mbari që nuk do të kishin kërkuar më tepër, një djalë të bukur si Filipi, dhe do të kishim pasur një Martesë të Vërtetë me lajmërim në gazetën *Le Figaro*, ndoshta edhe fotografi, në vend të këtij kremtimi në rreth të ngushtë që bie erë rregullarizim. Ajo gjithashtu mendon, në një kohë të dytë, që, ashtu naiv si ishte ky, i kapur në kurthin e ndjesive, mund të kishte peshkuar një prostitutë në zanat, por sidoqoftë nuk shkoi deri atje. Ajo më përqafton me trishtim të thellë. Ka veshur një pallto ngjyrë bezhe prej mëndafshi të egër; motra e saj Ireana është veshur me tafta pastel; Stefania me qëndisma të bardha angleze si për moshën e saj; dhe Kamila ime, dëshmitarja ime dhe mbështetësja ime e vetme – jo shoqja ime më e mirë por më e paraqitshmja, dhe të cilën e kisha marrë në emër të interesit të përgjithshëm, mjaftoja unë për të lënë përshtypje dhe pastaj kur vjen puna për t’u argëtuar, e kotë të ftoja miqtë të përfitonin – ka veshur një si gjë rozë flamingo fringo të re, dhe të gjithë mendojnë se është ajo nusja: si mund ta hamendësojnë një gjë të tillë për këtë kushërirë province, që po përjeton një zi tani së fundmi, dhe që përpiket ta fshehtë? Kapa befas

një vështrim nostalgjik të zonjës Enjan mbi Kamilën: të kishte marrë këtë të paktën! – Shkurt vetëm unë jam me të zeza në mes të gjithë këtyre hortensiave të lulëzuara, unë me veshje prej leshi të zi këtë mëngjes të shndritshëm, në mes të pranverës, dhe kulmi, bën mot i bukur. Uroj me gjithë zemër të bjerë shi. A nuk thotë dhe ajo fjala e urtë që duhet të bjerë shi që të shkojë mbarë martesë? Asnjë pikë shiu nuk ra gjithë ditën.

Atë ditë. Ku arrijmë të dorëzuar. Dokumentet; mua vetëm të shoh një copë letër më bie damllaja. Blerjet: gjithë ato gjëra që duhen blerë për t'u martuar, nuk ta merr mendja; dhe përse. Vizat: duhet vrapuar me t'u bërë gjëja, nuk mund të presë puna, a thua bashkia është motor reaksioni. Noteri; Ndarja; kjo është më e lezetshmja : martohesh dhe pikërisht në të njëjtën kohë ndahesh; por për të ndarë çfarë? të Mirat e tij nga Jo-të Mirat e mia; Dashuri e përjetshme por edhe masa në rast se, Dorëzim Total, por prit, aspak! Më pëlqeu Noteri. Sapo kisha dalë nga klinika, më solli menjëherë në vete; e kuptova menjëherë ku isha. Me gjithë këto, si të vija me qejf në dasmë? Këto gjëra më shkatërrojnë. E sigurt që nuk kam për ta bërë më. Ose do të marr një sekretar që të më përfaqësojë.

Dje shkova për t'u rrëfyer. Për dëshminë. E pyeta: Çfarë mund t'i them unë atij tipit? Më jep ndonjë ide.

- Dëgjo, nuk do të të diktoj unë se çfarë do të rrëfesh ti!

- Po ti çfarë do t'i thuash?

- Nuk ka ç'të duhet ty!

Për besë, kishte ndërmend ta bënte seriozisht ai? Nga ato që më kishte thënë më përpara, kisha kuptuar se ishte mendimtar i lirë, dhe është në partinë radikale; modern, por sidoqoftë.

- Epo, do t'i them që kam shtypur mollë. Përndryshe shkon gjashtë muaj. Dhe nuk do të më japë faljen. Dhe dëshminë. Jam e detyruar të sajtoj. Do t'i lexoj Xhoisin. Për më tepër nuk e di as Rrëfyesin. Unë rrëfhem te Zoti i gjithëpushtetshëm Jezu Krishti biri i tij i vetëm, e lumturuara virgjëresha Mari virgjëreshë dhe nënë, dhe te të gjithë shenjtët, me siguri e ngatërroj me Kredon, se kam mëkatuar shumë, me mendim, me fjalë, me veprime, por tani çka, më mirë, *mea culpa mea culpa...*

- Dëgjo, është vërtet e nevojshme?

Ai është nervoz si një asistent i dytë filmi dhe për pak sa nuk godet makinën para që e shan nga nëna. Unë qesh. Nuk i pëlqen që qesh. Përfitoj nga rasti për t'i thënë që dëgjoj një zhurmë në motor, këtë gjë bëj zakonisht kur shoferi pranë meje është nervoz. Kështu qetësohen. Jam e dëshpëruar por e kam tmerr të vdes ashtu kot. Ai e dëgjon me qetësi motorin deri në sheshin Sën-Sylpis. Kjo është famullia ime, më duket. Në pragun e ndërtesës, stepem. E di që atje është ftohtë. Herën e fundit që kam qenë atje ishte për të ngritur çorapen, që kishte rënë. Bënte ftohtë.

I them: e kam bezdi të shkoj atje. Përse gjithë ky cirk?

- Ti e di mirë që është për prindërit e mi. E zgjidhëm këtë çështje në kohën e duhur, nuk e kuptoj përse e hap prapë tani.

- Sepse kam ecur me kohën. Po janë vërtet besimtarë prindërit e tu?

- Një martesë civile do t'i vinte në siklet. Mirëpo nuk shoh asnjë arsye për t'i vënë në siklet.

- Është e frikshme.

- Çfarë është e frikshme?

- Nëse ke fëmijë, ata martohen në kishë për të mos të vënë në siklet? Dhe kështu historia vazhdon deri në fund, askush nuk e di çfarë është, por historia vazhdon. Dhe ty nuk të duket e frikshme kjo.

- Se çfarë po kërkon.

- Zotin në Kishë po kërkoj, asgjë e çuditshme apo jo?

- Por nuk është aty puna! Vetëm duhet të kesh një dëshmi rrëfimi. Është e thjeshtë. Nuk është metafizikë. Nuk do të ndryshosh kurrë ti? Hyr, nuk do të rrimë në shkallë deri sa ty të të mbushet mendja. Kemi ende shumë për të bërë sot.

- E kam bezdi. Është e shëmtuar ta bësh këtë.

- Dëgjo, duhet ta kishe menduar më parë.

- Por tani e di. Prej këmbëve të mia.

- Po qe se bën metafizikë me këmbët e tua, nuk më habit më asgjë. Sidoqoftë është shumë vonë, letrat janë gati, takimi është lënë. Madje është paguar.

- Epo meqë qenka paguar, mirë. Sidoqoftë, që unë të shkel në një kishë, jo, të betohem, duhet që të të

dua. Seriozisht Filip, të lutem ta marrësh këtë si provë dashurie.

- Por mike e dashur përpiku të jesh pak logjike: ose nuk u jep asnjë rëndësi këtyre gjërave sikurse pretendon dhe rrjedhimisht aq të bën të futësh këmbët, siç thua ti, në një kishë, ose, nëse të shqetëson kjo gjë, do të thotë se u jep rëndësi këtyre gjërave, dhe në këtë rast mjaft bëre si shpirt rebel. Përpiku të jesh pak më e sinqertë.

Pas kësaj, më mbetet vetëm ta qep.

- E di çfarë kam bërë herën e fundit që kam qenë aty brenda?

- Jo dhe nuk dua ta ti. Për herë të fundit, m'i kurse të tilla konfidenca.

Ku t'i ketë shkuar mendja?

*

Bien kambanat. Koha është e bukur. U martova.

- Nuk dukesh e gëzuar, më thotë Kamila; e mërzhitur edhe ajo, budallallëk që e vendosa aty, por duhej dikush.

- Bëra gabim që u martova në kishë.

- Tipike e jotja kjo. E thua pasi del.

- Nga ta dija unë më parë.

Bëra gabim që hoqa dorë nga feja ime për t'i bërë qejfin zonjës Enjan. Zonja Enjan nuk ia vlen një heqje

dorë nga feja. Askush xhanëm. Nuk duhet ta kisha bërë, kaq. Bëra gabim. Por cilit Zot t'i kërkoshe falje dhe mëshirë? Të krishterët janë me fat, e kanë dikë. Kurse ne jemi në dorë të vetes tonë. Nuk do t'ia fal vetes këtë. Nuk ishte i vërtetë, arsyetimi i saj. E unë e hëngra. Po tani, mos duhet të shkoj të shkungohem në Romë për të qenë në rregull?

Thonë që dashuria fal gjithçka. Nuk jam e sigurt. Ec, të shkojmë. Filipi – pa shih, këtu qenka? – më hap derën e makinës me ceremoni. Më duket se më kërciti krahu. Qetësohu, vetëm dreka ka mbetur për t'u hequr qafe. Dhe pastaj, jeta. Shofer, te Karmel.

- Sidoqoftë, kemi ditë të bukur, vëren Irena, kur vërshojmë të gjithë grumbull tek Enjanët, ku organizohet dreka, meqë nusja nuk ka familje. As edhe një re, thotë ajo. Gjë e rrallë për këtë stinë. Jemi me fat, e mbyll ajo.

- A nuk është më mirë që të bjerë shi në dasmë që martesë të funksionojë? thotë Bruno, të cilin dasma e vëllait të madh nuk e ka zbutur. Kështu kam dëgjuar të thonë.

- Nuk e di ku e ke dëgjuar këtë, - i përgjigjet e ëma.
- Kjo nuk ekziston. Ndoshta e ke shpikur.

- E kam dëgjuar, - thotë Bruno.

- Edhe unë mama, - e mbështet Stefania.

- Janë histori ndrikullash, - u thotë e ëma me një shikim të inatosur që nuk u bën fort përshtypje dy engjëjve.

- Ndoshta në fshat, - thotë Irena për të rregulluar gjërat.

- Jo ishte në kinema, - thotë Stefania.

- Dua të them, - saktëson Irena, - ndoshta është e vërtetë në fshat ku moti ka shumë rëndësi. Për bujqësinë. Por këtu...

- A jeni lodhur Selinë? - pyet zonja Enjan për të ndryshuar temë.

Jam e shkatërruar. E vdekur. Sikur ça kam bërë, asgjë të madhe. U martova. Ku është Filipi ? Po flet me të atin. Nëse do të mos e njohësh më tjetrin, mjafton të martohesh. Kur mendoj që dikur flinim bashkë ! Kur e shikoja tek vinte ato kohë, zemra ime brofte nga gëzimi. Çfarë po bëj këtu? Nuk njoh asnjëri, me përjashtim të Kamilës, të cilës i varem si gocë deti.

- Dukesh e përhumbar fare moj vajzë.

- Ashtu jam. Nuk njoh njeri këtu. Po sikur të shkojmë gjetkë?

- Martesa të shkon si dorashka peshkut të kuq. Po si ia bëre?

- Nuk e mbaj mend mirë. Ishte një histori e shpifur, me goca deti. Pastaj fjeta. Mendoj se ishte elektrohok. U zgjova sot në mëngjes tepër e trishtuar; tepër vonë, mesha ishte paguar.

U zgjova është fjalë e madhe. "Ejani rehatohuni", - më thotë zonja Enjan që nuk duron dot më të më shohë të mbirë si vazo. Heq xhaketen, dhe shfaqem me një këmishë romantike, me tirqe; diçka si Harpo Marks në rolin e Sisit. Ç'm'u desh që e bleva edhe këtë? Çfarë kujtoja unë? Se do më shikonin gunën, jo punën? Thellë-thellë, është tragjedi e vullnetit të mirë:

u përpoqa vërtet të vishesha si nuse, por nuk ia them. Vështa përsëri xhakëtën: ishte akoma më e shëmtuar poshtë; ose përndryshe të zhvishesha lakuriq. Kapa vështrimin e zonjës Enjan mbi barkun tim. Sigurisht. Ajo priste të isha nja pesë muajshe; vetëm për këtë arsye martohesh. Ja që jo, e dashur Zonjë, jam e sheshtë si fletë, kam higjienë dhe parime. Epo atëherë, për mëshirë përgjigjet ajo (kam telepati për rastet e thjeshta) një vajzë e gjorë e sëmure në klinikë kurë gjumi, depresion nervor gjoja që në të vërtetë duhet të ishte tentativë vetëvrasjeje me qëllim për t'i hedhur grepin djalit tim gati për ta lënë për një nga ato vajzat e shumta që vetëm këtë kërkonin – dhe që, për parantezë, e dashur Zonjë vijnë për t'u mpleksur me bohemët në festat e lagjes, madje takova disa syresh rastësisht në banjë, dhe as më shkon në mend t'i kritikoj - pra djali im i gjorë iu dorëzua shantazhit mendon nëna. Unë i buzëqesh. E dashur Zonjë djali juaj martohet me mua për dashuri, e trishtueshme por e vërtetë.

Pa kapele, është progres sidoqoftë. Kreh flokët me gishta si zakonisht. Pothuaj po e njoh veten time. E tres uiskin në një gjysmë litre uji. Kam etje. Kë të pyes ku janë tualetet? Pyes Stefaninë; në moshën e saj e kuptojmë akoma jetën. Ajo më udhëheq në një korridor pa fund.

- Është akoma larg? Mezi eci. Këtu e kam pasur mendjen që në bashki.

- Edhe duke thënë “Po”?

- Aty më kapi.

Ajo kthen nga unë një fytyrë të habitur: mos mashtron pamja ime? Sytë e saj më pyesin; sy të bukur të paturpshëm të cilëve përpiqem t'u përgjigjem. Më në fund arrijmë te vendi. Kur dal, ajo po më pret: se mos humbja; më mirë? Po, tani mund të pi. Për të harruar? thotë ajo. Nuk e di, madje nuk e di çfarë kam për të harruar. Ajo qesh. Me çfarë merreshit më parë? Janë kureshtare vajzat e reja. Para çfarë? Para se të martoheshit me Filipin. Striptizë. Oh, thotë Stefania me admirim, e kuptoj pse është inatosur mamaja. Ajo nuk e di, them unë, ia kemi fshehur. Kuptoj, thotë Stefania, më mirë kështu, as unë nuk ia them, mund të keni besim tek unë. Oh, tani nuk ka rëndësi, i them unë, nuk do të vazhdoj besoj, Filipi nuk do, thotë që fiton mjaftueshëm për të dy. Fiton shumë me striptizë? Oh, sa për të jetuar. Është e çuditshme që po martoheni me Filipin, thotë ajo. Po, vërtet, kështu mendoj edhe unë.

Kur hyjmë ne në sallon, kumbojnë tinguj të kobshëm: Tam, tam, tatam, tam, tatam, tatam, tatam...

- Bruno! - këlthet nëna, - po kjo ç'është!

- Çfarë, - thotë ai, - është marshi martesor. Mos, jo, paskam ngatërruar anë, është funebri. Më falni, - më thotë mua kalimthi. Konstaton që mua më vjen për të qeshur dhe i mbetet disku në ajër.

- S'ka gjë, - i them, - edhe kjo e bukur është, më pëlqen shumë muzika.

- Ka ndonjë gjë që keni qejf të dëgjoni? - thotë ai.

- Ndoshta Heroiken? - them unë. - Ose Brasens...
Oh, a e keni *Cool* ?

- Që tani? - thotë Bruno.

- Ndoshta pak më vonë?...

Jam ulur për tokë, edhe Stefania; po rrëmojmë nëpër disqe; tanimë shtyhet disi. Stefania do një këngë të Ferre, e ke parasysh tipin që kap shërbyesen dhe ha luleradhique? Ata do inatosen, ne do shkrihem.

- Zonjës iu plotësua dëshira

- Duhet të jem unë, kjo, Zonja?

- Mos, - thotë Bruno, - sa fillova ta rregulloja.

Te borgjezët hahet keq, e kam konstatuar shumë herë. Dhe pjatat nuk qarkullojnë shumë. Për çfarë i ruajnë më pas, lind pyetja. Edhe në një dasmë. I kanë porositur të gjitha me catering, ushqim i rafinuar por i stërbërë. Epo, s'ke ç'i bën, siç thotë Filipi.

Dy fëmijët atje, në anën tjetër më bëjnë herë pas here shenja inteligjence; sa mirë që janë ata se të tjerët... Farefisi dhe Filipi e kanë shteruar plotësisht temën e Muajit të Mjaltit, Filipi i di me saktësi të gjitha vendet ku do të shkojmë e çfarë do shohim, madje nuk ka pse marrim mundimin të shkojmë. Unë nuk mora pjesë, nuk jam aq e zonja në gjeografi, ishte pika ime më e dobët, më e mira ishte matematika por nuk të hyn në punë në bisedë. Pleqtë, duke lidhur idetë njëra pas tjetrës, na dhanë shembull udhëtimet e tyre, Venecia e Veriut, Tulipanët dhe Fjordet; tani shkohet më tepër në jug; bën më ngrohtë, thotë Irena,

dhe Filipi saktëson se ka edhe det, edhe në Veri ka thotë zonja Enjan, por nuk është i njëjti, në jug është Mesdheu tregon Irena, Mesdheu është në modë tani, madje edhe në këtë stinë ku nuk ka ende turma të shpifura si në korrik, dhe çmimet, gjithashtu, duhet përfituar, është edhe mali, thotë znj.Enjan, mua më pëlqen shumë mali, është i shëndetshëm, ka ajër, edhe ai është shumë në modë, sidomos në pranverë, pa atë turmën e dimrit, por për Muaj Mjalti, thekson zonja Enjan mali ndoshta nuk rekomandohet shumë, Përse, pyet Irena, Përse jo? Thyen ndonjë këmbë, ndërhyt Bruno dhe në këtë rast nuk është shumë mirë, Unë do të kisha dashur të shkoja në Spanjë, e ndërpret Filipi, i pakënaqur nga ndërhyrja e vëllait të vogël, por Selina nuk e pëlqen Spanjën, të gjithë bërtasin, si kështu nuk e pëlqeni Spanjën, si mund të mos e pëlqeni Spanjën! E njihni? Më pyesin, e dini duhet ta njohësh mirë, ka disa vende të fshehta kur turistët nuk shkojnë dhe atje duhet shkuar, keni qenë? Jo. Hera e parë që e hap. Epo përderisa nuk keni shkuar? Filipi buzëqesh me dashamirësi, më merr dorën: asaj nuk i pëlqen. Nuk më pëlqen Flamenko, them unë. Si ka mundësi nuk e pëlqeni Flamenkon është kaq i bukur! - shpall Irena, dhe të tjerët në kor, ata e pëlqejnë shumë Flamenkon, e kanë në gjak francezët, dihet, mjafton të shohësh si përplasnin duart te Kitara ose te *Barrio Chino* në Paris me një flakë egërsisht cigane dhe në kontrotempo, pastaj Spanja është shumë lirë thotë zonja Enjan.

Për më tepër nuk më pëlqejnë as korridat, Por nëse nuk i keni parë kurrë, prisni e shikoni, si mund ta dini

? Edhe unë kujtoja që nuk do të më pëlqente, është kaq mizore, por pastaj i pashë një herë dhe u pushtova. Nga kush? - thotë Bruno. Bruno! - thotë babai por me tonin qortues të ëmbël, sepse nuk duhet prishur solemniteti i kësaj ditë, Irena qesh për të treguar që nuk është mërzhitur dhe vazhdon me përshkrimin e Si u pushtua nga Korrida (ahah) dhe i hodhi dorashkat tutje dhe një prej tyre përfundoi në bririn e demit kafsha e gjorë dukej aq qesharake. Ndoshta vetëm nëse më garantojnë vdekjen e toreros, thashë me vendosmëri, po qenka sadiste kjo vajzë! - këlthet Irena e mallëngjyer. Ata janë të mrekullueshëm. Por ju nuk i njihni rregullat, thotë zoti Enjan, që m'i shpjegon, sepse ai i njeh nga fillimi në fund, nuk i mbetet gjë tjetër vetëm të shkojë t'i zbatojë në arenë. Dhe pastaj Spanja nuk është shtrenjtë thotë zonja Enjan që harroi se e tha njëherë, as Jugosllavia thotë Filipi, dhe ja ku ia nisin përsëri për valutat, Koston e Jetës në çdo cep të botës, të llogaritur sigurisht sipas raportit mes pagës së punëtorit indigjen dhe çmimit të kiles për bukën e trashë, dhe ta ndaj qindarkën në mënyrë të tillë që në një javë, me disa akrobaci në kursin e këmbimit, arrijnë të fitojnë një dhjetë qindarka, dhe këtu i humbas nga vëmendja një çast për të kapur një petull dhe i gjej përsëri në Begatinë e Vendit, Urën e Tankarvillit Autostrada e Jugut Pjerlat. Kur më erdhi në majë të hundës nga gjithë ato budallallëqe që dëgjova deklarova: deri sa të pëlcasë gjithandej sepse është bosh poshtë sistemit

tyre, e dini si e quajnë situatën këtu në shtypin e huaj? Inflacion. Nuk i lexoni gazetatat e huaja? Heshtje, dhe babai, tanimë edhe i imi, më vështron ëndërrimtar një sekondë duke thënë që ditën e dasmës nuk mund të më dërgojë për të qëndisur, dhe me një buzëqeshje atërore, thotë: Ne po e mërzitim këtë vajzë me këto tema të mërzitshme, ka të drejtë që na i vuri në dukje, shpresoj që do të jetë mjaftueshëm nxehtë atje që të laheni? Ajo do të marrë maskën e saj, ia pret me të shpejtë Filipi i emocionuar. Jo? Admiron babai, qenkeni gjahtare nënujore? Oh jo! Them unë. Vetëm sa shikoj. Kurrë nuk do të doja të vrisja një peshk e kam tmerr gjahun e të gjitha llojeve është qesharak si argëtim dhe jashtëzakonisht i kushtueshëm, dhe gjithë ajo rrumpallë. Çne rrumpallë! - këlthet ai, këtë herë aspak i kënaqur dhe duke harruar solemnitetin e ditës sepse ai shkon çdo vjeshtë për gjah, gjë që unë e di por doja të gjallëroja pak atmosferën përndryshe më ra hunda në pulën me pilaf; ia filloj: fazanë të shkretë që i ushqen me kokrra misri gjithë vitin, ua jep në dorë dhe që vijnë me vrap kur i thërret si pulat dhe pastaj një ditë të bukur një bandë njerëzish të armatosur deri në grykë vijnë dhe qëllojnë pa paralajmërim, ju e quani këtë sport? Selinë, murmurit Filipi nëpër dhëmbë por tani që arrita të nervozohem nuk do ta lë me kaq, nuk e kam zakon të duroj kaq shumë, në rast të tilla në përgjithësi ia mbath, por këtu nuk kam mundësi duhet të bëj diçka. Keni qenë ju? Përsëri Irena, këtë herë mosbesuese, ka filluar të kuptojë që nuk ka qenë

askund (askund ku duhet). Unë kurrën e kurrës! them me përçmim. Epo nuk mund ta dini, thotë Irena. Ajo flet me zemër, thotë zoti Enjan që e ka marrë veten. Por unë: megjithatë e kuptoj se si mund të gjuhët derri i egër me shtizë. Kurse unë nuk po kuptoj asgjë, thotë babai, nëse jeni e ndjeshme, shtiza... Ua thashë, është sadiste, thotë Irena djallëzore. Filipi nxin: po bëj gafa njëra pas tjetrës, nuk di si të më ndalojë, do të më nxihet vendi ku më godet me gju prej një farë kohe. Nuk mund t'i kërkoni tim ati të gjuajë derrin e egër thotë Bruno, nuk do të kthehej më; me fazanët edhe mundet, herën e fundit pati një të vdekur. E vrau një gjahtar tha Stefania, jo një fazan. Pak rëndësi ka, thotë Bruno, do të isha më i qetë sikur të gjuante kapelen¹ Lëre tani, thotë nëna. Ju nuk e dini sa i rrezikshëm mund të jetë derri i egër, më thotë, duke mos çarë kokën për fëmijët, Nemrodi i Shtatorit: kur sulmon. Epo pikërisht, kjo e bën interesant, përndryshe nuk ka sport. U thashë, vazhdoi Irena, pas vdekjes së toreadorit, vdekja e gjahtarit. Është sadiste ajo. Ja dhe ëmbëlsira thotë zonja Enjan, a thua nuk po e shikonim një sajesë, por e goditur, të gjithë te ëmbëlsira, Duhet ta prisni ju Celinë. Mjaft me shampanjën më pëshpërit Filipi kur po kalonte shishja, je nervoze. Për lumturinë tuaj, thotë babi, i vendosur që kjo ditë të vazhdojë

¹ Gjahtarët e kapelave, në romanin Tartarin de Tarascon emër për gjahtarët që zbaviteshin duke marrë në shenjë kapela në vend të gjahut të vërtetë. (Shën. përkth.)

në hare, pavarësisht të gjithave, ngre gotën, për lumturinë e ju të dyve, zonja Enjan fshin një lot krejt formal, ju zgjattë më shumë se mua thotë Kushërira Eme duke derdhur shumë lotë, i shoqi sapo ka vdekur nga kanceri, siç na tregoi pak më parë në momentin e antipastës më të gjitha hollësitë, një karcinomë në zorrë, ne ngremë gotat, ndërsa nga salloni tjetër na vjen një melodi që e njoh mirë shoqëruar me fjalët e famshme: “Nuk ka dashuri të lumtura.” Bruno zë vendin e tij në tavolinë si i pafajshëm. Ky djalë di të lidhë gjërat, kam për t’ia thënë ndonjë ditë.

Testi nëse një këngë është e mirë: kur ajo fillon të gjithë heshtin, edhe budallenjtë. E dëgjojmë të gjithë në heshtje solemne.

Papritur sytë më mbushen me lot. Diçka që më ndodh shpesh kohët e fundit. Nuk e di nga më vijnë.

*

Do ikim! thërret Filipi në veshin tim, mos po flija gjë? Ai nuk thërret, pëshpërit; jam në një divan. Në spital ndoshta. Jo është dhomë, është Perandoria me varëse. E neveritshme për më tepër; si jeshile; e shpifur. Koka jo fort në rregull, e sapo dalë nga depresioni nervor; mos ishte më tepër tentativë vetëvrasjeje, thonë disa zëra, një prej të cilëve i njohur, shët thotë Filipi, u zgjua, po fliste zonja Enjan e cila shfaqet tani, është më mirë? Po, po thotë Filipi me tonin e dikujt që mezi po duron, po vijnë t’ju themi

mirupafshim tani menjëherë, po vijnë me ju, na lër, Edhe të pata thënë që të mos pije shumë më thotë mua kur mbetemi vetëm, ti e di mirë që nuk e përballon dot! Dhe pikërisht sot! Sa do të kisha dashur që të sillleshe si duhet. Të paktën për ditën! Por kjo është shumë për ty. Bën ecejake i inatosur.

Mirë, e kuptoj çfarë është. Normale. Çështja është çfarë kam bërë gjatë. E njoh veten. Ma kanë treguar më parë, e kam idenë për këto raste. Por për momentin më mirë të mos bëj pyetje. Nisur nga pamja e tij duhet ta kem menderosur.

- Je në gjendje të mbahesh në këmbë? Pa t'u marrë këmbët? Ta shohim? Unë fiksoj vijat e parketit. Për mendimin tim jam fort në rregull, i ndjek hap pas hapi.

E përshkoj me nder sallonin, që është i madh sidoqoftë; nuk ka nevojë që Filipi të më shtrëngojë krahun kaq fort, me siguri e ngatërron pak erë nëpër vello me poliomelitin; më dhemb. Dhoma e madhe tani është shkretëtirë në krahësim me pak më parë kur ishte plotë gjatë koktejit. Paska patur koktej. Zot, kam kaluar një koktej të tërë pa e vënë re? Nuk është mirë të jesh i hutuar deri në këtë pikë. Sa më sheh mua, fytyra e Stafanisë ndriçon: sikur të mund ta lexoja! ajo me sa duket paska kujtime të mira nga kokteji. Sa keq që duhet të largoheni thotë Bruno me një pamje që nënkupton diçka, por çfarë? Do vij përsëri, them fare rastësisht. Shpresoj thotë ai, për sa më përket mua derën e keni hapur. Aj aj, duhet të ketë qenë keq

puna. Zoti Enjan, babai, më puth sidoqoftë, edhe pse me cepin e buzëve; shpresoj që pas këtij udhëtimi do ta merrni plotësisht veten, më thotë ai, pushoni mjaftueshëm mbi të gjitha. Ka një leukoplast mbi faqe që nuk e kishte më parë, nga i erdhi? Fale baba thotë Filipi, ti e di që ajo nuk është ende shumë, që ajo është ende pak... Unë e fal sigurisht që e fal thotë babai (për çfarë, o Zot), në një ditë të tillë falim gjithçka, E kuptoj shumë mirë biri im e harrova, hajde, bëni qejf fëmijë dhe kthehuni në formë!

Çurga e fundit, zonja Enjan; ajo shkëputet nga vejusha e kancerogjenit, që nuk i ndahet, për të përqaftuar të birin; ndjell hundët; hajt pra mama thotë Filipi, hajt, se nuk po shkoj në luftë. Ajo nuk duket e sigurt. Nuk është çurgë, është lumë, faqja e saj është e lagur, për fat të mirë nuk qëndron gjatë mbi faqen time, i mungon entuziazmi le të themi. Mbaroi. Jo, nuk do t'i shpëtoj vejushës së kancerogjenit që me sa duket ka pritur këtë moment për të zbrazur zemrën, se ajo nuk donte të prishte këtë ditë por nuk mund të rrijë pa thënë se sa e vështirë ishte për atë që sapo e kishte humbur, të shihte një Lumturi të Re të merrte vrullin për Fillimin e Jetës, që na i uronte të gjatë, të gjatë, të gjatë, zonja Enjan e tërhoqi para se të arrinte te përjetësia dhe mori Filipin mënjanë për rekomandimet e fundit për të disatën herë. Qëndroja shumë mirë në këmbë pa të. Dikush më zgjati një shami për të fshirë nga fytyra ime prej nuseje lotët e Vejushës, nuk ishte Veronika, ishte Kamila, në formë të shkëlqyer, Si ka

mundësi që je akoma këtu sepse mezi po e shtyje kur të pashë herën e fundit, Gjeta një arsye për të qëndruar thotë ajo dhe me vështrim tregoi Brunon që ia ktheu me një buzëqeshje tepër moskokëçarëse. Ah. E shpejtë Kamila. Edhe unë kam qenë dikur. Dikur. Urime. Edhe ty, thotë ajo, ishe fantastike. Unë? Çfarë? Çfarë bëra? E bëra me dikë? Me kë? Jo, me kë do ta bëje përveç se me burrin tënd përderisa Bruno ishte në duart e mia, jo, por ishe fantastike gjithsesi. Sidomos fjalimi tek Karmel. Zot Gjahu i gjahtarëve ishte po ashtu sukses, sa qeshëm, dua të them ne të tre. Jo të tjerët. Kurse striptiza pastaj...

- Do vish? - thotë Filipi.

-Mirupafshim, - thotë Kamila, dhe urime gjithashtu për ngjyrën e zezë, tregove shumë guxim që e bëre.

- Vërtet? Kështu mendova dhe unë, në mëngjes, kur e kuptova ç'po bëja.

- Do vish? - thotë Filipi.

*

Asnjëherë ideja për të bërë dashuri nuk ka qenë kurrë kaq e huaj për mua.

Dua të fle. Të pushoj. Çfarë dite. Jam e mbaruar. Copë mishi. Çfarë, tronditesh kur martohesh, apo jo? Nuk tretet si gjethe sallate. Po ndryshoj jetën, ej. Kjo të lodh. Jam e dërrmuar, dua të fle. Dhe pastaj gjithë ajo shampanjë, pas gjithë asaj vere; ato verërat; mania që kanë ata për t'i përzierë; kjo të shkatërron.

Më parë kur Filipi dhe unë gjendeshim në një shtrat, ishte për të bërë dashuri. Përndryshe kishim dhomat tona. Tani dhe nga ky moment, kemi vetëm një shtrat për të fjetur. Ai gjendet aty tashmë. Shkoj dhe unë. Dua të fle. Ose të mos fle. Të mendoj. Të ëndërroj. Të qetësohem. Nuk e di. Dua kohë. Të marr veten. Të mësohem me këtë. Ose të bëjmë muhabet? Nuk e di. Kurse ai më vjen sipër.

Mirë, nëse ai nuk e ka kuptuar gjithë këtë nuk do të filloj t'ia shpjegoj. Shumë e gjatë. Shumë e ndërlikuar. Varja, ç'muhabet është ky, një burrë që është i dashuri im prej gjashtë muajsh. Le të jemi të thjeshtë. Le ta lëmë të kalojë.

E lehtë ta thuash. Duhet edhe. Kurse ai:

- Çfarë ka?

Unë:

- Asgjë... ndoshta jam pak e lodhur...

Ai:

- Që tani?

Dhe ja. Priteni. Mbaroi. Vdekje. Greminë. Kur ndodhesh këtu, nuk ka asgjë për të bërë. Është tepër vonë. Duhet ta kuptonte vetë. Ne jetë ka vetëm një mënyrë për të kuptuar: të kuptosh veten. Përndryshe, gjithçka është e kotë, shpjegime, sqarime dhe kaq. Ajo që mund të bëjmë është të përpiqemi ta kalojmë. Këtë u përpoqa unë. Por nuk kontrollojmë gjithçka, trupi nuk do t'ia dijë për taktika, për të, gjërat janë ato që janë: nuk ishte fort mikpritëse. Nuk kemi ç'bëjmë. Në fakt po vras mendjen si ia bëjnë prostitutat. Duhet ta kenë një marifet. Përndryshe nuk është e mundur.

Unë nëse nuk jam gati, ndodh masakër.

Ai u rras në anën tjetër të krevatit; me shpinën e kthyer. I mbyllur në dinjitetin e burrit të fyer. Të burrit; ai vetëm kaq donte.

Nuk mund të kuptosh ti ? Nuk mund të kuptosh? Nuk mund të kuptosh? Nuk mund të shohësh? Të paktën të shohësh? Sepse është e qartë. Një ditë e tillë dhe duhet të jem e freskët si gonxhe? Ti kujton se familja jote është afrodiziak? Sikur të kishe pak mirëkuptim, duhet të më lije tetë ditë për ta tretur! Shto pastaj edhe udhëtimin me makinë, dyqind kilometra me dyqind e dyzet në orë, dhe në heshtje, Zotëria me dinjitet në timon pa thënë një fjalë, shprehte me këtë neverinë për pijanecen e hedhur në ndenjësen e pasme me një brutalitet të tillë që do t'i kishte marrë disa shuplaka nga ndonjë më e guximshme se unë, edhe kjo po që të ndez barkun, s'ke ç'i thua. Çfarë kujtojnë ata se jemi ne? Prej çfarë jemi bërë? Prej mishi? Dhe pas kësaj asnjë gjest, asnjë fjalë në shtrat për ta përgatitur pak situatën, Dita ishte e vështirë ose Më në fund, iku, diçka disi njerëzore apo jo? Dikur më afroheshe gjithmonë me disa delikatesa paraprake, kurrë dikur...

Ah por dikur ishte dikur. Sot je burri im. Nuk ka më favore, ka detyrime. Budalla. Dhe mezi po më prisnin, aha ah. Të shohim çdo të bëjë ajo, tani që është e martuar. Që ai ishte martuar me mua. Ahah. Mezi po më priste, me përfundimin gati - "Që tani"? u dërgua si shigjetë, në sekondë: ishte bërë gati që më

parë. Dhe fluturoi ulët. Oh tipi i neveritshëm! Tani në anën tjetër të krevatit, tepër larg. Aty le të rrijë.

Po zemra ime. Ja edhe diçka që nuk mund të kontrollohet, ah, kokalla e shpifur, zemra ime përplasat me të gjitha kockat, dhe ja kafazi i krahavorit që dhemb, o zot kotka që më ngjitet, tablo e plotë klinike, gropa në gjoks, për pak do të më merret fryma. Jam në agoni. Është e padurueshme. Nuk ka mundësi. Duhet të dal që këtu, ose vdiq. A mund të më sjellë dikush kripë. Jo, e kam seriozisht, po vdes vërtet. E dua! Filip!

Po tani çfarë do të bëjmë? Po iki, s'kam çfarë të bëj tjetër. Është e pamundur, kaq. Ec, në këmbë. Çohu. Dëgjove kokallë. Por ajo nuk dëgjon. Po vuan e shkreta. I dhemb. Ja filloi të qajë. Pas pak do të fillojë të thotë babi mami. Kaq ishte, po flet; ajo thotë: Filip, të lutem...

- Jam i lodhur.

Pa shih, nuk po fle ama. E hedh topin në fushën time. Ia fut kot por e hedh, nuk ka marrë fund gjithçka.

- Eh epo nuk ka si të mos jesh i lodhur. Unë e kuptoj që je i lodhur.

- T'u desh kohë të gjesh justifikime?

I lodhshëm. Gjysma ime do të donte të ishte më mirë njëqind kilometra larg sesa të merresha me këto budallallëqe. Por gjysma tjetër nuk do të largohet prej këtej. Për asgjë në botë. Gjysma ime numër dy më mirë e vret gjysmën numër një; këtë bën në fakt. Ajo përsërit Filip të lutem, me sa duket kaq di të thotë. Por ama funksionon. Ai lëviz.

Po të isha pak shejtane, ky do të ishte momenti të ktheja dhe unë shpinën, po të isha pak kurvë. Por nuk jam shejtane, nuk jam kurvë, e dua. Oh dreq. Kokalla lëviz gjithashtu.

- Nuk qenke më e lodhur papritur?

- Jo.

T'i biem shkurt. Në të vërtetë jam e rraskapitur dhe për më tepër e neveritur, por e vërteta të shkojë nga erdhi nuk ka vend për të këtu. Pjesa tjetër t'i lihet Natyrës, që nuk vë shumë re. Çfarë pune. O zot ju lutem bëni që gjatë asaj kohe trupi im të bindet pak, që i dashuri të mos hasë në shkretëtirë. Nuk e di por ai vendosi të mos merret me hollësitë këtë herë. Kishte frikë, edhe ai. Cili prej të dyve ka pasur më shumë frikë? Ah, gjë e bukur dashuria. Për pjesën tjetër duhet vetëm të kem besim, për fat ai ka mënyrën e duhur; madje kështu më bëri për vete. Janë të rrallë këta: ne befasohemi. Ka që më kuptojnë. Të nesërmen e kësaj “befasie” e njohur më tepër me emrin “Goditje rrufeje”, shkova takova Tomasin dhe i thashë: s’ke ç’i bën, ai ka mënyrën e duhur. Ishte për justifikim. Nuk mund të biem çmendurisht në dashuri me një tjetër, ne mes të një marrëdhënieje të bukur, pa paraqitur shpjegime. Në ato kohë isha e pafajshme, nuk e mendoja se kjo rrjedhë duhet të ndërpritej; mendoja se Tomasi, mik i shkëlqyer, nga ata që ruajmë, do të mërzitej pak në fillim të këtij pasioni që po lindte, dhe pastaj një ditë, herët a vonë, gjithçka do të rikthehej në atë që unë e quaj rregull, kurse Filipi e quan çrregull; dhe jeta

vazhdon. “A ishe e lumtur kështu?” Epo le të themi që nuk isha fatkeqe. Kjo pyetje nuk shtrrohej. Jetonim. Gjërat vinin ashtu si vinin; i merrnim; kalonim; ose, më saktë, ato kalonin. Në atë kohë gjithçka rridhte natyrshëm. Dashuronim gjithë kohën, dhe a kishte vërtet nevojë për dikë tjetër? Kam dashur qytetet, përmes njerëzve. “Dhe mund të më thuash çfarë të ka mbetur nga kjo?” Po ja, më kanë mbetur qytetet; muzika vera aroma ngjyra tinguj drita; na mbetet jeta vetë. Ajo që jemi. Plus diçka tjetër, që nuk e kishim më parë, dhe që e pikasim vetëm nëse kemi qenë mjaftueshëm të trazuar në moshë të njomë. Diçka që ka të bëjë me dashurinë vetë dhe që e zgjeron diçka. Nuk di të them më shumë, nuk pata kohë të përfundoja studimet. U desh të sakrifikohej Tomasi, dhe plotësisht, nuk duhet as ta takoja më. Të tjerët nuk më kushtonin, kalimtarë ishin. “Ose unë, ose ai.” Menjëherë ultimatumi. Dhuna. Nxitimi. Çfarë zakonesh. Ja pra përfundimet. Nuk mund t’i lënë të shkojnë gjërat, me respektin përkatës. Çfarë nuk na shohin sytë apo jo? Jo. Ata u urdhërojnë gjërave të jenë ashtu si u pëlqen atyre të jenë. Ndonjëherë kjo funksionon. Në dukje. Ndër të tjera, kështu e kanë pushtuar botën. Po, por me çfarë çmimi?, kjo mbetet për t’u parë. Tomasi u sakrifiku, ç’të bëja? Isha e bllokuar. Dhe ja si na bëjnë të humbim dëlirësinë. Ajo që më ligështon, thotë ai, nuk është që po të humb, por që po të humb kaq kot. Unë të kuptoj – por çfarë është dashuria? Nga vjen pasioni? – dhe ku shkon?

As unë nuk e dija. Tomasi u sakrifikua, por me çfarë çmimi do të na i thotë e ardhmja. Në fillim i jepen me vrull dhe i kuptojnë pasojat kur u bien mbi kokë. Nga vjen pasioni? ku përfundon ai? Përse trupi im është këtu, i mbushur me një shpirt të lënduar? mendoja në krahët e Filipit, edhe mënyra e duhur lë vend për të vrarë mendjen dhe unë kur bëj dashuri , frymëzohem, më qartësohen mendimet. U nisëm në agim sipas programit, pa mbyllur mirë sytë. Ai e pati Natën e Martesës.

Ai që në jetën e vet nuk ka vendosur kurrë perde të dyfishta nuk mund të kuptojë. Nuk i reziston dot. E dimë veten të fortë, por perdet e dyfishta janë akoma më të forta. Në fillim i kapim nga lart, bëjmë pak sikur të ishte dikush tjetër, që do ta vështrojmë gjithë qejf tek zgjidhte perdet e dyfishta, një tjetër që do të ishte le të themi shërbëtori juaj, jo ju, sepse ju nuk mund të jepen pas perdeve të dyfishta, jeni jashtë kësaj. Dhe pastaj paf. Kaq ishte. Çfarë ndodhi? Nuk kemi kohë të shohim, ashtu si nuk kemi kohë të shohim kur na zë gjumi. Biem në tipin që zgjidhte perdet e dyfishta, në shërbëtorin, jemi njësh me të, e harrojmë plotësisht ekzistencën e tjetrit, domethënë të vetes. Përpihemi. Shumë e rëndësishme zgjedhja e perdeve të dyfishta. Ngjyra; copa; derdhja e copës (fillojmë të përdorim fjalë të tilla!); do ta vendosim dyshe apo jo? Shumë e rëndësishme. Gjithçka shumë e rëndësishme. Copat e rënda në përgjithësi janë të shëmtuara te Zoti; çfarë nuk kanë shpikur; ndërmarrje për përçudnimin e shijes. Rafti i perdeve është muzeu i tmerreve. “Por Zonjë, ne shesim shumë nga këto” ja argumenti kyç.

E ç'më duhet mua se ç'pëlqejnë të tjerët? Nuk keni diçka të thjeshtë për ata që janë normalë?" "Por Zonjë, këto prodhohen." Këto prodhojnë fabrikantët, po, e shoh, por për atë që do klienti, e çajmë kokën apo jo? Ne shesim shumë si këto Zonjë. Pash Zotin çfarë mund të blejnë tjetër njerëzit, blejnë atë që gjendet! Nuk mund të blenë atë që nuk gjendet! Nuk ka gjasë. E padurueshme. Kjo është diktaturë. Për perdet e dyfishta Zonjë? Shihni më mirë në rajonin e mobilimit. Dal, nuk ka asgjë. Asgjë? Shitësja e bërë sterrë vështrojnë sipërfaqen e madhe të rajonit të mallkuar. Por kjo Zonjë nuk është perde e dyfishtë, është dublura. Dhe çfarë ju bën të merrni vendimin që është dublura? Nëse i var në dritare a nuk do të jenë perde të dyfishta?

Semantika ime! Njerëzit janë lëmsh. Nuk e dinë më se çfarë është një gjë, dinë vetëm se çfarë është një emër. Bleva saten për ta kundërshtuar, shitësja ishte e tronditur. Dhe tani mbulesa e krevatit, që duhet, ose nuk duhet, të kombinohet me perdet. Lexoni France - Femme dhe do të dini si jetohet. Ju lutem një metër e gjashtëdhjetë. Kjo nuk ekziston Zonjë. Si nuk ekzistua? Mobiljet janë të mëdha në përgjithësi. Gjerësia në mobiljet zonjë është një metër e tridhjetë. Por qenka budallallëk! Kështu është. Si t'ia bëjmë me një metër e tridhjetë mbi një shtrat, a nuk janë një metër e dyzet shtretërit? Ah atëherë shikonin në rajonin e krevateve Zonjë, meqë interesoheni për krevat. Rajoni i krevateve për krevatet. Ju duket

tronditëse që unë guxoj të kërkoj gjetkë, që dal nga burgu i fjalës. Që kërkoj atë që dëshiroj dhe nuk marr atë që më propozojnë. Nga kam dalë që nuk e di që nuk është oferta që i përgjigjet kërkesës por kërkesa që duhet t'i bindet ofertës. Ato e dinë, që sistemi ka rrëshqitur, ose më mirë ato nuk e dinë, kanë rrëshqitur bashkë me të. Nuk është faji i tyre, sistemi i paguan. Paguhen tre groshë dhe gjithmonë në këmbë dhe marrin leje për të bërë ççin, por njeriu është malli i lirë. Në darkë do t'i tregojë të shoqit: kishim një të luajtur sot; unë përshkoj Shëtitorët e Tregtisë në kërkim të logjikës, ajo ka të drejtë me siguri. Do të doja cohë pambuku por pa xhufkat. Kjo nuk bëhet Zonjë. Përse. Sepse kështu është kjo nuk bëhet Zonjë. Dhe përse nuk bëhet kjo? Ajo nervozohet. Nuk na e kërkojnë Zonjë. Po unë a nuk po ta kërkoj? Jo nuk është kështu: nuk e kërkojnë, kurse unë që e kërkoj nuk ekzistoj. Më mohojnë. Presin vetëm që të largohem. Mekanikë e sofistikuar për të prodhuar dele. Nuk do t'i kem perdet e mia nëse vazhdoj. Ose do të duhet të dorëzohem, do të fitojnë ata; janë të fortë. Kanë vendosur që këtë vit të kemi tiganët tango, njëlloj si gratë e tjera. Nuk ka pse. Sepse po t'i linim njerëzit të qetë ata idiotët do t'i blinin tiganet një herë e mirë dhe ku do përfundonim kështu; duhet të mbrohem nga këta budallenj që po të mos i shkundësh jetojnë akoma në pemë duke mbledhur fruta. U duhen gjetur vazhdimisht gjëra të reja që të nxjerrin kuletën, janë kaq kopracë. Çantat, rrobat e banjës janë po ashtu

tango këtë vit, nuk e di nëse e vutë re, dhe po të lexoni France – Femme do të shihni që po bëjnë kërdrinë në çdo faqe dhe nëse nuk i blini dhe ju do të dukeni si thes. Ky është urdhër. Ngjyrat e përzgjedhura më sulmojnë nga të gjitha anët, dhunojnë sytë e mi, ngjishen në trurin tim. Dhe si përfundim nuk janë aq keq: nuanca të studiuara mirë, Komitetet Koordinimi janë marrë me orë të tëra e merrni me mend nuk është kot, ata zotërinj nuk e humbin kohën kot me ylber, dhe pastaj si me magji tiganët blu e zbehtë siç i dua nuk gjenden nëpër raftet e dyqaneve: nuk i bëjnë më Zonjë – do të telendisem akoma me kërkime të kota, të bëhem arkeologe tiganësh vetëm prej kokëfortësisë? Ec, do të ishte akoma më budallallëk të ngulësh këmbë, dhe pastaj ç'më duhet mua ngjyra e tiganëve, se mos do t'i shoh ndonjëherë, do të kem shërbëtore. Kthehem me një komplet “turtulleshë”, e dërrmuar, gati për të shpërthyer në lotë, e shtypur nga sistemi.

- Nuk e kuptoj se si mund të përjetosh një tragjedi duke përshkuar një dyqan të madh, thotë Filipi. Nuk ka pse. Duhet ta kesh nga lodhja.

- Por xhufkat janë të lezetshme, thotë zonja Enjan. Sidomos për në dhomë. Por nëse e doni të thjeshtë, keni tylin prej najloni që lahet shumë më lehtë dhe nuk hekuroset.

Zonja Enjan flet si shitësja ime; kanë të njëjtën sintaksë. Në fund të fundit është logjika: të dyja merren me tregti, lart apo poshtë pak rëndësi ka.